

Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Direktorja për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

Nr./Br. 013104-8235
Data 27-22-2019
Gjakovë - Djakovica - Gjakova



Komuna e Gjakovës

LËNDA: Trajnim për Mësimdhënësit e Komunës së Gjakovës - të akredituar nga MASHT për Zhvillim Profesional dhe Licencim

Të nderuar:

American Advising Center (AAC), organizatë e themeluar nga Departamenti i Shtetit Amerikan nëpërmjet Ambasadës Amerikane në Kosovë, ka dizajnuar programin Akademia EducationUSA e Mësimdhënësve dhe është akredituar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për ofrimin e trajnimeve për Zhvillim Profesional dhe Licencim të Mësimdhënësve të Republikës së Kosovës.

Program Trajnimi: "Këshillim për Studime në SHBA dhe Bursa" - 50 Orë Certifikim

Me mirësi kërkojmë nga Ju që të zyrtarizojmë Marrëveshjen e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit në mes dy palëve, në bazë së cilës AAC do të ofrojë trajnimin e lartëpërmendur për zhvillimin profesional dhe licencimin 50 mësimdhënësve të Komunës së Gjakovës - të ndarë në dy - 2 - grupe.

Të bashkangjitur keni përshkrimin e programit/trajnitimit si dhe marrëveshjen e lartëpërmendur për të zyrtarizuar.

Ju faleminderit, paraprakisht, për bashkëpunimin Tuaj.

Me respekt,

Liri Kadriu



AKADEMIA EducationUSA PËR MËSIMDHËNËSIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PROGRAM TRAJNIMI:

"Këshillim për studime në SHBA dhe bursa"

Akreditimi:

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - (MASHT) - Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM) - 50 Orë Certifikim - Trajnim për Zhvillim Profesional dhe [Ri]Licencim të Mësimdhënësve parauniversitar të Republikës së Kosovës.

American Advising Center - AAC - është qendër zyrtare, në Kosovë, e rrjetit EducationUSA e themelur nga Departamenti i Shtetit Amerikan nëpërmjet Ambasadës Amerikane në Prishtinë, me qëllim të ofrimit të ndihmës nxënësve, studentëve, mësimdhënësve nga Kosova për të studiuar në SHBA dhe/ose botë, me bursa.

Përmbajtja:

Trajnimi "Këshillimi për studime në SHBA dhe bursa" është *program trajnues plotësues* për mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta, gjimnazeve dhe shkollave profesionale.

Qëllimi kryesor i trajnimit "Këshillimi për studime në SHBA dhe bursa" është që të aftësojë mësimdhënësit e Republikës së Kosovës në ofrimin e informatave dhe përgatitjeve të nxënësve për studime në SHBA dhe/ose botë, me bursa.

- 1.1 Rrjeti EducationUSA - Programi orientues për këshilltarë të rinjë
- 1.2 Pesë hapat për të studiuar në SHBA
- 1.3 Këshillimi për universitete dhe kolegje - CollegeBoard
- 1.4 Konkurimi në universitetet dhe kolegjet amerikane
- 1.5 Vetëdijsim dhe përgatitje për universitet dhe kolegjet amerikane
- 1.6 Testet Standardizuese - TOEFL dhe SAT
- 1.7 Pranimi në universitetet selektive amerikane dhe ndërkombëtare
- 1.8 CommonApp dhe aplikacionet për të studiuar në SHBA
- 1.9 Rekomandimet, esetë dhe aktivitetet jashtë shkollore
- 1.10 Bursat akademike dhe në bazë të nevojës për të studiuar në SHBA



Qëllimet dhe Rezultatet:

Pas përfundimit të trajnimit "Këshillimi për studime në SHBA dhe bursa", mësimdhënësit do të aftësohen për:

- Këshillim të nxënësve të shkollës dhe/ose komunitetit rreth mundësive për studime në SHBA dhe bursa
- Ndihmë nxënësve në procesin e konkurimit për studime dhe bursa në SHBA
- Përgatitje të nxënësve për testet standardizuese TOEFL dhe SAT
- Krijimin një strukturë për mësimdhënien, në shkollë e komunitet, që nxit te menduarit kritik dhe të nxënët e pavarur.
- Të shërbyerë si burim përvojë dhe njohurish për mësimdhënësit, drejtorët, prinderit dhe nxënësit e tjerë

Struktura dhe Planifikimi:

Trajnimi "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa" ka 50 orë certifikim.

Sesionet e trajnimit mbahen *gjatë ditëve të fundjavës - Shtunë dhe Diele* - duke filluar nga ora 9:00 deri 17:30, me pauza.

Gjithësej, tri [3] fundjavë sesione trajnuese dhe një prezentim/konsultim me stafin e AACEdUSA Kosovo, janë të nevojshme për certifikim të mësimdhënësve.

Trajnimet zhvillohet në klasë të një shkolle të përcaktuar më herët, në komunën përkatëse, me trajner të certifikuar dhe akredituar nga MASHT dhe AAC - EdUSA Kosovo - Prishtinë.

Sesionet e trajnimit janë grupor - 20-25 mësimdhënës në një grup.

Cmimi për një mësimdhënës është 155EURO - duke përfshirë materialet dhe shpenzimet administrative të trajnimit, pauzat freskuese, librin origjinal dhe të përditësuar për përgatitje për testet standardizues si dhe certifikatën.

American Advising Center - EducationUSA Kosovo

Fakulteti i Edukimit

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" info@aacks.org

- +383 44 56 60 70 **AGJENDA E TRAJNIMIT** - "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa"



SESIONET 1 & 2 - DATAT: _____

Rrjeti EducationUSA - Programi orientues për këshilltarë të rinjë
Pesë hapat për të studiuar në SHBA
Këshillim për universitete dhe kolegje - CollegeBoard
Vetëdijsim dhe përgatitje për universitet dhe kolegje

SESIONET 3 & 4 - DATAT: _____

Konkurimi dhe pranimi në universitetet dhe kolegjet amerikane dhe ndërkombëtare
CommonApp dhe aplikacionet për të studiuar në SHBA
Rekomandimet, esetë dhe aktivitetet jashtë shkollore

SESIONET 5 & 6 - DATAT: _____

Bursat akademike dhe në bazë të nevojës për të studiuar në SHBA
Aplikacionet për bursa studimi në SHBA - CSS Profile
Testet Standardizuese TOEFL & SAT

PREZENTIMI:



CERTIFIKATA E TRAJNIMIT:



Education
USA



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE

MINISTARSTVO OSBAZOVANJA
NAUKA I TEKNOLOGJIE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

CERTIFIKATË

për pjesëmarrje në program trajnimit:
Akademia EducationUSA - Këshillim për studime në SHBA dhe bursa (50 orë)

DATA, VENDI

XXXXXX
Trajneri



MEMORANDUM MIRËKUPITIMI DHE BASHKËPUNIMI NË MES TË AMERICAN ADVISING CENTER - EdUSA KOSOVO DHE KOMUNËS SË GJAKOVËS

American Advising Center - EdUSA Kosovo (AAC - EdUSA Kosovo) dhe Komuna e Gjakovës ("Komuna e Gjakovës") të referuar së bashku këtu si "Partnerët," përmes këtij Memorandumi të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit pajtohen që të krijojnë partneritetin për Akademinë EducationUSA të Mësimdhënësve dhe ofrimin e trajnimit "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa" për mësimdhënësit e Komunës së Gjakovës. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është: 1 shkurt 2019 deri më 31 dhjetor 2019, me mundësi vazhdimi.

Qëllimi

Bien dakord që AAC - EdUSA Kosovo, në mënyrë që të ofrojë informata për studimet në SHBA, këshillime akademike për nxënësit, studentët dhe mësimdhënësit të cilët dëshirojnë të studiojnë në SHBA, si dhe teste dhe burime për studimet në SHBA, është në interesin më të mirë të përbashkët të palëve të kësaj marrëveshje, Partnerët pajtohen që të marrin pjesë bashkë në *Programin Akademia EducationUSA e Mësimdhënësve të Republikës së Kosovës* për ofrimin e trajnimit "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa" për mësimdhënësit e Komunës së Gjakovës. Trajnimi është i akredituar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për Zhvillim Profesional dhe Licencim të Mësimdhënësve parauniversitar. Secili Partner ka obligime dhe përgjegjësi specifike sipas kushteve të kësaj Marrëveshje të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit.

Në mënyrë specifike, Komuna e Gjakovës do të ofrojë mbështetjen si në vijim:

1. Të ofroj hapësirë - klasë - me kushte të kënaqshme dhe pa pagesë brenda një shkolle në komunë për mbajtjen trajnimit "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa". Trajnimet mbahen gjatë tri - 3 - fundjavëve - Shtune dhe Diele.
2. Të ndihmojë në përcaktimin e mësimdhënësve që do të jenë pjesë e trajnimit të lartëpërmendur.
3. Të ofrojë përkrahje të përgjithshme stafit të American Advising Center - EdUSA Kosovo dhe Ambasadës Amerikane në Kosovë për të mbikëqyrur, mirëmbajtur dhe monitoruar koleksionin e burimeve të ofruara si dhe shërbimet këshilluese me informata rreth arsimit universitar në SHBA.



4. Të siguroj që koleksioni dhe shërbimet e ofruara promovohen brenda shkollave të Komunës së Gjakovës dhe që janë të hapura për të gjithë ata individë në Kosovë të cilët janë të interesuar të ndjekin studimet universitare në SHBA.
5. Të bashkëpunojnë me AAC për shpërndarjen e materialeve të përgatitura nga Departamenti i Shtetit të cilat ofrohen nga Ambasada Amerikane në Prishtinë te klientët siç janë në dispozicion
6. Të ofrojë hapësirë dhe përkrahje për ngjarjet dhe programet e AAC- EdUSA Kosovo të cilat ndërlidhen me studimet në SHBA dhe mundësitë për shkëmbim.
7. Të ofrojë mundësi për stafin e AAC për prezantimin e programeve dhe aktiviteteve të nxënësit dhe mësimitdhënësit të Komunës së Gjakovës.
8. Të mbulojë shpenzimet financiare për dy - 2 - grupe të mësimitdhënësve - 20 - 25 mësimitdhënës për grup - për ndjekjen e trajnimit të lartëpërmendur dhe certifikim. Mësimitdhënësit duhet të jenë të shkollave të mesme të larta, gjimnaze dhe/ose shkolla profesionale. Pagesat do të bëhen nëpërmjet transferit bankar pasi që AAC - EdUSA dorëzon faturën për pagesë.
9. Të caktojë një person kontaktues përbrenda Komunës së Gjakovës që do të shërbej si ndërlidhje në mes të AAC - EdUSA Kosovo dhe Komunës së Gjakovës.
10. Personi kontaktues të jetë prezent në ceremoninë e certifikimit.

Në mënyrë specifike, AAC - EdUSA Kosovo do të ofrojë mbështetjen si në vijim:

1. Të ofrojë trajnimin "Këshillim për studime në SHBA dhe bursa" të akredituar nga *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - (MASHT) - Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimitdhënësve (KSHLM) - 50 Orë Certifikim - për zhvillim profesional dhe licencim të mësimitdhënësve.*
2. Të ofrojë, kur janë të disponueshme, publikimet e Departamentit të Shtetit të SHBA-së për studime në SHBA, dhe materiale të tjera për studim nga SHBA.



3. Të ofrojë prezente dhe sesione informuese mbi studimet në SHBA, bursat akademike dhe testet standardizuese TOEFL dhe SAT në shkollat dhe organizatat e Komunës së Gjakovës.
4. Të sigurojë materiale, kur janë të disponueshme, për programet dhe grantet e Qeverisë së SHBA-së, mundësi për edukim dhe mbështetje financiare në Shtetet e Bashkuara për shpërndarjen e tyre në Komunë.
5. Të ofrojë këshillime dhe udhëzime të përgjithshme dhe pa pagesë rreth universiteteve, për nxënësit dhe studentët e Komunës së Gjakovës.



Mosrespektimi i Marrëveshjes

AAC - EdUSA Kosovo ka të drejtën që të vlerësojë nëse ndonjë pjesë e kësaj marrëveshje nuk është respektuar. Nëse konstatohet që partnerët nuk kanë respektuar kushtet e kësaj marrëveshje, zotëron të drejtën për të thirrur Partnerët në takim për rivlerësimin e kushteve të kësaj marrëveshje apo për ndërmarrjen e masave të tjera që i vlerëson si të nevojshme për të garantuar pajtueshmërinë.

Nënshkrimet


Palët si më poshtë kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje Mirëkuptimi me 20 shkurt 2019.

Për American Advising Center
- EducationUSA Kosovo:

Për:  

American Advising Center -
EducationUSA Kosovo

Për Komunën e Gjakovës:

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës